

## PUNA

---

### TË DREJTAT E NJERIUT NË BOTËN E PUNËS

### E DREJTA PËR PUNË DHE TË DREJTAT E NJERIUT TË LIDHURA ME PUNËN

---

>>... *Paqja universale dhe e përhershme mund të arrihet vetëm nëse është e bazuar në drejtësinë shoqërore...*<<

### KUSHTETUTA E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARË TË PUNËS

#### TREGIM ILUSTRUES

#### **Kushtet e tmerrshme të punës në zonat e lira të tregtisë**

*Një vajzë e vogël e quajtur Xiao Shen, që jetonte në një fshat rural të quajtur Zhangyan i cili gjendej në mes të Kinës, kishte një jetë të ashpër. Ajo kishte pak ose fare oriz për të ngrënë dhe asnjë shpresë për të ardhmen. Çdo ditë ajo duhej që të zhytej në ujë për t'i ndihmuar të atit të saj me të korrat e orizit. Një ditë, më në fund, ajo vendosi që të ikte. Ajo kishte dëgjuar për një vend të huaj më të mirë diku larg përtej maleve të rrezikshme. Dhe, një mëngjes, ajo dhe disa shokë të saj që i kishin ndarë ëndrrat për një jetë më të mirë u larguan nga shtëpia. Dy mijë kilometra dhe ditë të panumërta të lodhjes, ankthesh dhe lotëve të panumër, t për të arritur më vonë në destinacionin e tyre- një qytet i quajtur Shenz'hen, afër kufirit me Hong Kongun dhe zonë e tregtisë së lirë në jug të Kinës. Atje ato shpresuan se do të gjejnë punë, të fitojnë të holla dhe të përmbushin ëndrrat e tyre. Ndodhi që Xiao Shen të njihet me dy ndërmarrës të quajtur Huang Guoguang dhe Lao Z'haquan, të cilët punësonin punëtorë për "Fabrikën e tyre Zejtaria Z'hili" një fabrikë që prodhonte lodra. Xiao Shen u bë njëra nga 472 punëtorët dhe së shpejti ajo kuptoi se ajo ishte në pozitë shumë më të keqe sesa në fshatin e saj të vogël. Nga agimi deri në mbrëmje ajo ishte rropatur në fabrikën Z'hili – për një pagë me të cilë vdisje urie – e mjaftueshme vetëm për të mbijetuar(26-40 Euro në muaj!). Dy biznesmenët ishin të frikësuar se punëtorët mund t'i vidhnin të mirat materiale të tyre, kështu që e kishin bërë fabrikën si burg, ku punëtorët jetonin 24 orë në ditë. Të gjitha dritaret ishin me grila, kurse daljet e emergjencës ishin të mbyllura. Mbikëqyrësit e shtetit ishin të korruptuar*

*dhe nuk ua vinin veshin këtyre kushteve. Ditë pas dite Xiao Shen jetonte bas grilave, pa mundësi që të dilte jashtë, pa mundësur ta jetonte një jetë normale dhe pa hapësirën e saj të jetës. Në pasdrekën e 19 Nëntorit të vitit 1993, shpërtheu një zjarr i cili u shpërnda shpejt në të gjithë ndërtesën e fabrikës më një shpejtësi të pakontrollueshme. Shumë kemikalie të ndezshme ishin deponuar nëpër objekt, duke shkaktuar një ferr të pamasë. Xiao Shen dhe të tjerët dëshprueshëm u munduan që t'i ikin zjarrit – por si? Të gjitha dritaret ishin griluar dhe të gjitha dyert ishin mbyllur. Dyqind meshkuj dhe femra, shumë prej të cilëve jo më të vjetër se 16 vjeç, ishin rrethuar nga flaka dhe thërrisnin për jetët e tyre. Xiao Shen disi ia arriti që ta thejx grilën e njëres nga dritaret në katin e dytë dhe u gjet para zgjedhjes që të kërcente ose të digjej e gjallë. Ajo vendosi të kërcente, duke i thyer të dy nyjat e këmbëve, por, së paku, mbijetoi. Të gjithë së bashku, 87 njerëz kanë humbur jetën atë pasdite dhe më shumë se 47 u lënduan rëndë.*

## **BURIMI**

KY TREGIM ËSHTË HULUMTUAR NGA DY GAZETARË TË QUAJTUR KLAUS WERNER DHE NANS WEISS, DHE ËSHTË MARRË NGA PUBLIKIMI I TYRE “LIBRI I ZI MBI KOMPANITË E MARKAVE”. SI NJË FAKT QË INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE DHE OJQ-TË JANË DUKE U BRENGOSUR PËR KUSHTET E KËQIJA TË PUNËS NË TË ASHTUQUAJTURAT “ZONAT E LIRA TREGTARE”.

## **PYETJE PËR DISKUTIM:**

1. Cilat të drejta të njeriut janë shkelur nga kushtet në të cilat ka punuar Xiao Shen?
2. Cilat janë problemet më të mëdha lidhur me të drejtën për punë?
3. Cilat masa duhen ndërmarrë në shkallë ndërkombëtare për t'i rritur, apo së paku për t'i përmirësuar kushtet e punëtorëve si Xiao Shen?

## **E DOMOSDOSHME TË DIHET!?**

### **1. “BOTA E PUNËS NË SHEKULLIN XXI”**

Teknologjitë e reja dhe të dhënat globale kanë potencial që ta transformojnë botën më shumë sesa revolucioni industrial. Falë industrisë në rritje, shekulli XX ka përjetuar një dobësim të sektorit të agrokulturës dhe një rritje të rëndësishme të sektorit të shërbimeve. Liberalizimi i tregut botëror dhe “revolucioni kibernetik” ka rritur mundësitë për ekonomimë globale.

Kjo **ekonomi e re globale** është grishje për punëtorët e specializuar, të cilët duhet të trajnohen mirë, të jenë fleksibilë dhe të motivuar, si dhe të gatshëm për t’iu adaptuar shpejt kërkesave të tashme të tregut. Punëtorët duhet të përballen me stresin në rritje dhe ndërrimin e kushteve të punës nga pikëpamja e ndryshimeve të shpejta teknologjike dhe strukturore. Gjithnjë e më shumë njerëz punojnë pjesërisht, vetëpunësohen apo përballen me kushte jostabile të punës. Në këtë pikëpamje globalizmi po nxjerr në pah zbrastësitat sociale në mes të atyre me arsimim, aftësi dhe gatishmëri që të lulëzojnë në një ekonomi botërore të integruar, dhe atyre pa këto gjëra. Këto pabarazi dhe pasiguri të reja po çojnë në tensione në mes të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë. Konkurenca e lartë si rezultat i liberalizimit të tregtisë dhe regjimet financiare shfaqin një presion të madh mbi kompanitë që t’i zvogëlojnë kostot e prodhimit. Për t’i arritur këto caqe, ato ose mund ta zvogëlojnë faktorin e rritjes së kostos së prodhimit dhe “punën” nëpërmejt automatizimit, duke e bërë fuqinë punëtore tepëricë, apo duke transferuar prodhimin në shtetet me fuqi të lirë punëtore ku standardet shoqërore janë shumë më të ulëta. Paga dhe kushtet e punës mund të keqësohen. Shumë shpesh pasojë e kësaj janë shfrytëzimi dhe puna e dhunshme e fëmijëve. Fenomeni i “globalizimit” i godet njerëzit në të gjitha pjesët e botës, por të mirat e tij janë shpërndarë pabarazisht.

Qeveritë, megjithatë, kanë zvogëluar fuqinë për lehtësuar efektet negative të barrierave të ulëta tregtare, kryesisht falë “lojtarëve të rinj global”: ndëmarrjeve multinacionale.

**Dimensionin shoqëror i globalizimit** është bërë brenga më e madhe e politikave ndërkombëtare. Më shumë se kurrë është më rëndësi që të promovohen standardet shoqërore dhe të drejtat e njeriut në shkallë ndërkombëtare në mënyrë që të sigurojmë stabilitetin shoqëror, paqen dhe zhvillimin, duke i dhënë njerëzi ekonomisë globale.

### **Puna dhe siguria njerëzore**

Siguria ekonomike dhe sociale është një aspekt i rëndësishëm i sigurisë njerëzore. Në këtë pikëpamje e drejta për punë dhe të drejtat gjatë punës luajnë një rol të rëndësishëm për arritjen e sigurisë njerëzore. Njerëzit pa një qasje në punë janë ose të varur nga ndihma sociale, ose nuk kanë fare prespektivë. E drejta për punë si një standard i të drejtave të njeriut shkon përtej mbrojtjes së mbijetesës, për arsye se kënaqja e nevojës themelore nuk do të mjaftojë për ta rritur sigurinë njerëzore. Të drejtat e punëtorëve sigurojnë kushte të përshtatshme për punë, por po ashtu edhe mbrojnë kundrejt diskriminimit dhe shfrytëzimit në vendin e punës. Puna nuk duhet ta sigurojë vetëm mirëqenien, por ka të bëjë me raportet dhe pjesëmarrjen në shoqëri. Është shumë ngushtë e ndërlidhur me vetëvendosjen, vetërespektin, vetërealizimin, dhe nga këto rrjedh se është e ndërlidhur edhe me dinjitetin njerëzor. Veç kësaj, ajo mund të çojë në pasiguri personale, rrezik, kushte jo të shëndetshme dhe të padrejta. Papunësia dhe mohimi i sindikatave janë prirje për krijuar trazira dhe kështu të krijohet pasiguri dhe jostabilitet në shoqëri. Për këto arsye, promovimi apo shtytja e standardeve për kushte të përshtatshme të punës pa shfrytëzim është kusht për përmirësimin e sigurisë njerëzore.

Në mënyrë që ta kuptojmë dimensionin njerëzor të fuqisë punëtore është e nevojshme që  
**“ TË SHIKOJMË MBRAPA NË HISTORI”**

Roli i drejtësisë shoqërore dhe kushtet e mira të punës si shtytje drejt paqes dhe zhvillimit nuk duhen nënvlerësuar. Padrejtësitë, mundimet dhe privimi i ndërlidhur me punë janë të prirura për të prodhuar shqetësime. Njohja e aktit se puna e përshtatshme është një parakusht për dinjitetin njerëzor në të shumtën e rasteve është rezultat i luftës të punëtorëve për të drejtat e tyre. Si rrjedhim, të drejtat e punëtorëve janë shkrirë në legjislacionin e ONP që nga viti 1919 dhe në rregullimin e standardeve të KB pas Luftës së Dytë Botërore.

**Shekulli XVIII:** Ideja se puna është një e drejtë themelore për të gjithë përbërësit e shoqërisë ishte një kërkesë së pari e shtruar në **Revolucionin Francez**. Çarls Fourije, një filozof utopist, ishte i pari që e përdori termin “e drejta për punë” dhe theksoi se rëndësia e punës nuk qëndron vetëm në mirëqenien sociale, por edhe për atë psikologjike të

individit. Ai pohonte se shtetet kanë obligim të ofrojnë shanse të barabarta dhe konkludoi se realizimi i kësaj të drejte do të kërkonte një riorganizim të tërësishëm të shoqërisë. Do ta hasim përsëri këtë vizion të të drejtë për punën, në teoritë socialiste; qeveritë komuniste e kanë promovuar sërish më vonë. Mund të thuhet, prandaj, se e drejta për punë ka mjaft “traditë socialiste”.

**Shekulli XIX: Revolucioni industrial** shkaktoi shfaqjen e klasës punëtore, një grup social i cili varej nga paga e punës, falë mungesës së mjeteve të prodhimit. Punëtorët ishin shfrytëzuar dhe vuanin kushte të rrezikshme të punës në fabrika, tjeritore dhe miniera. Varfërimi i punëtorëve krijoi një lloj solidariteti në mes tyre dhe ata filluan të organizohen (Karl Marksi në “Punëtorë te Botës, Bashkohuni!”).

Gradualisht, zëri i punëtorëve u rrit dhe situata e tyre bëhej publike çdo herë e më shumë. Falë presioneve nga **sindikatat** e para, në një numër vendesh ishin miratuar ligje mbi reformat të ndërlidhura me orët dhe kushtet e punës. Vazhdimësia e shqetësimeve të punëtorëve prapë u bënte presion industrialistëve dhe qeverive që t’i merrnin parasysh masat e mëtejshme.

**Shekulli XX:** Disa industrialistë propozuan që të rregullohen standarde të përbashkëta ndërkombëtare në mënyrë që ta shmangin avantazhin konkurrues të popujve të cilët shpërfillnin standardet e punës dhe më në fund në vitin 1905 dhe 1906 u miratuan dy konventat e para për punën. Iniciativat për skicim dhe miratim të konventave të tjera u ndërpre në Lufta e Parë Botërore.

Traktati i Versajës, i cili e përfundoi luftën, më në fund kishte njohur ndërvarjen në mes kushteve të punës, drejtësisë sociale dhe paqes universale në një *shkallë ndërkombëtare*, duke caktuar themelimin e ONP si një mekanizëm për përcaktimin e standardeve ndërkombëtare në fushat e punës dhe të fuqisë punëtore.

Në këtë kontekst, koncepti i punës si një vlerë njerëzore, nevoja sociale dhe mjetet e vetërealizimit u zhvilluan dhe u shtuan.

Në mes viteve 1919 dhe 1933 ONP ka skicuar dyzet konventa, duke i adresuar një mori çështjesh të ndërlidhura me punë.

Përplasja e tregut të stoqeve në vitin 1929, e njohur si “ E premtja e zezë” rezultoi si një pengesë e ashpër. Ajo shkaktoi ngecje të madhe ekonomike të përcjellër nga një shkallë e lartë e papunësisë. Pas kësaj filluan demonstratat dhe trazirat e të papunëve. Në Gjermani, kjo krizë botërore e ekonomisë u shoqërua nga disa kriza politike, duke i kontribuar ngritjes së Adolf Hitlerit dhe së fundi orientimit drejt Luftës së Dytë Botërore.

**Pas Luftës së Dytë Botërore:** Si pasojë **Kombet e Bashkuara** përfshinë çështjet ekonomike dhe sociale në qëllimet dhe programet e tyre për një rregull të ri botëror, për të parandaluar shkaktimin e sërishëm të një situatë të ngjashme. Lidhshmëria në mes të punës dhe dinjitetit njerëzor ishte theksuar në *Deklaratën Rreth Qëllimeve dhe Destinacionit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës* e miratuar në Filadelfi më 1944 ( e njohur si : Deklarata e Filadelfisë”; e inkorporuar në Kushtetutën e ONP më 1946) ku shkruan se “Puna nuk është produkt” dhe se “ të gjitha qeniet njerëzore ... kanë të drejtë ta ndjekin mirëqenien materiale dhe zhvillimin e tyre shpirtëror në kushtet e lirisë dhe dinjitetit, të sigurisë ekonomike dhe mundësive të barabarta.”

Kjo është thënë po ashtu në Enciklikën Papnore “Laborem Exercens” të vitit 1981, e cila thekson pozitën e punëtorëve si subjekte dhe jo objekte nga pikëpamja filozofike dhe religjioze.

Shumë është bërë nga ONP si dhe nga KB për të përmirësuar fatin e punëtorëve përgjatë botës. Sot, megjithatë, duke marrë parasysh ekonominë globale, sfida të reja dhe pasiguri të reja kërkojnë zgjidhje të reja dhe komplekse.

*>>Puna e pranueshme/përshtatshme është sot një kërkesë globale, e cila i kundërvihet ushëheqjes politike dhe të biznesit në të gjithë botën. E ardhmja jonë e përbashkët, në masë të madhe varet nga mënyra se si do ta përmbushim këtë sfidë <<*

**ILO, 1999.**

## **2. DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES**

Shembujt e shkeljes së të drejtave të njeriut në kontekst të punës radhitet prej fëmijëve që punojnë në miniera të qymyrgurit, e deri te sindikalistët që janë të burgosur në skllavërinë moderne, siç është puna e detyruar apo shfrytëzimi komercial dhe seksual i fëmijëve. Të

drejtat e njeriut, nga ky pikëshikim po ashtu merren me kushtet e vështira të punës siç është ambienti i pashëndetshëm dhe i rrezikshëm i punës apo shfrytëzimi i orëve të punës. Çështjet të cilat janë në këtë temë mbulojnë mbrojtjen e grupeve të cenuara në botën e punës, si për shembull femrat apo emigrantët. Së fundi, por jo me më pak rëndësi, duhet të diskutohet lidhja ndërmjet dinjitetit njerëzor, sigurisë njerëzore dhe kushteve të pranueshme të punës. Në vazhdim do të formohen dy mekanizma të mëdhenj ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtës për punë dhe të drejtat e punëtorëve, Sistemi i ONP në një anë dhe Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut në anën tjetër.

## **LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR I PUNËS**

### **Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP)**

Organizata Ndërkombëtare e Punës është krijuar në vitin 1919. Ishte themeluar që të duket se po rritet brenga për reforma sociale pas Luftës së Parë Botërore. Ajo është e bazuar në besimin e fuqishëm se varfëria është rrezik për përparimin dhe sigurinë kudo dhe qëllimi që t'i përmirësojë kushtet për njerëzit që punojnë përreth botës pa asnjë diskriminim në baza race, gjini apo prejardhje shoqërore. Më 1947 ONP u bë agjencioni i specializuar i Kombeve të Bashkuara dhe në vitin 1969 iu dha Çmimi Nobel i Paqes për punën e saj.

Në mes agjencioneve të KB, ONP është unike për shkak se ka **strukturë tripalëshe**, përmes së cilës vendimet e marra nga organet e saj përfqësojnë këndvështrimet e **punëtorëve** dhe **punëdhënësve** si edhe ato të **qeverisë**.

### **ONP**

- Krijon politikat dhe programet që të shtyje të drejtat themelore të njeriut, të përmirësojë kushtet e punës dhe të jetesës dhe t'i shtojë shanset e punësimit;
- Vë standarde ndërkombëtare (konventa dhe rekomandime) në këto fusha dhe monitoron zbatimin nacional të tyre;
- Drejton një program të gjerë të kooperimit teknik që t'i ndihmojë vendeve që t'i bëjnë politikat e tyre më efektive.

ONP ka skicuar diku rreth 180 konventa, duke caktuar standardet në fusha të caktuara si kushtet e punës, siguria profesionale dhe shëndeti, sigurimi social, politika e punësimit dhe trajnimi profesional dhe mbrojtja e femrave, emigrantëve dhe njerëzve vendës. Vetëm një sasi e vogël e konventave të ONP u referohet si **konventa të të drejtave themelore të njeriut**. Më poshtë, ju mund ta gjeni një listë të këtyre konventave të ONP së bashku me statusin e ratifikimit të tyre.

### **Konventat më të rëndësishme të ONP-së**

#### **Ratifikimi i konventave (bazë) të Organizatës Ndërkombëtare të Punës**

(deri më 8 Janar 2003)

| <b>Parimi</b>   | <b>Konventa</b>     | <b>Numri i vendeve që e kanë ratifikuar</b> |
|---|---------------------|---|
| Liria e asociacionit dhe mbrojtjes e të drejtës për të organizuar tubime të përbashkëta | Konventa 87 (1948)  | 141   |
| Mosha më e vogël e punës  | Konventa 98 (1949)  | 152   |
| Ndalimi i punës së detyrueshme  | Konventa 138 (1973) | 120   |
| Konventa 105 (1957)   | 158                 | 161   |
| Të drejtat për shpërblim të dhe ndalimi i diskriminimit në punësim dhe profesion        | Konventa 29 (1930)  | 160   |
|   | Konventa 100 (1951) | 158   |
|   | Konventa 111 (1958) |   |

#### **BURIMI**

ONP, 2003.

Si përgjigje ndaj sfidat e reja të paraqitura nga globalizmi me 18 Qershor të vitit 1998 ONP miratoi **Deklaratën mbi Parimet Themelore dhe të Drejtat për Punë dhe Vazhdimësia e tyre**. Në mënyrë precize definojnë se cili standard i punës apo të drejta të punëtorëve janë themelore, domethënë konventat kryesore të ONP të paraqitura në tabelën e mësipërme. Kjo ishte hapi i parë i drejtuar me kujdes në çështjet ndërkombëtare

për t'i përmbushur këto sfida. Ajo reflekton përkushtimin e shteteve për vlera të përbashkëta të shprehura në një numër të caktuar të rregullave, të cilat formojnë një "minimum social".

Deklarata është detyruese e të gjithë anëtarëve të ONP, pavarësisht se a i kanë ratifikuar konventat në fjalë apo jo. Shteteve të cilat nuk i kanë ratifikuar konventat u kërkohet që t'i dorëzojnë raportet mbi përparimin e bërë në zbatimin e parimeve të shkruara në deklaratë.

ONP po ashtu nxjerr raportin global mbi progresin e bërë në zbatimin e parimeve themelore të të gjitha shteteve anëtarëve për çdo katër vite, e cili shërben si bazë për caktimin e efektivitetit të veprimit të marrë gjatë periudhës paraprake.

## **TË DREJAT E NJERIUT TË LIDHURA ME PUNË NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

### **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut**

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut përmban një varg të të drejtave të njeriut të ndërlidhura me punë. Të gjitha këto të drejta janë zhvilluar më tutje në marrëveshjet të cilat e bëjnë të detyruar mbi palët shtetërore. Më poshtë mund ta gjeni përshkrimin e DUDN e të drejtave në fjalë, të cilat do të përshkruhen detajisht më pas.

*« Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose çifçi...Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor...Gjithkush ka të drejtë për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.*

*Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë. Gjithkush që punon ka të drejtën për shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme, ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror. Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë dhe bëjë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të veta. Gjithkush ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orarit të punës.... Gjithkush ka të drejtë për një nivel të mjaftueshëm jetese, i cili i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme, si të atij*

*personalisht, ashtu edhe të familjes së tij..... edhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, paaftësie .... dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë...*

## **DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT,**

NENET 4, 20, 23, 24 DHE 25

### **Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike**

*Liria nga skllavëria*

**Neni 8 i KNDCP** shpall se “*askush nuk duhet të mbahet në skllavëri... Nga askush nuk mund të kërkohet që të kryejë punë të detyrueshme apo të shtrënguar. ...*”

Edhe pse kundërshtohet botërisht, skllavëria dhe praktikat e punës së detyrueshme ende ekzistojnë në forma të ndryshme sot. Shpesh janë të ngulitura thellë në gjykimet ideologjike apo në trashëgiminë kulturore. Sipas ONP ekziston një lidhje e dukshme për strukturat jodemokratike. Miliona burra, gra dhe fëmijë në botë janë të detyruar që t’i jetojnë jetërat e tyre si skllavë. Ndonëse ky shfrytëzim nuk quhet skllavëri, kushtet janë të njëjta. Skllavi është:

- i detyruar të punojë – nëpërmjet kërcënimit fizik dhe psikik;
- i poseduar apo i kontrolluar nga “punëdhënësi” zakonisht nga keqpërdorimi psikik apo fizik apo kërcënimit për keqpërdorim;
- i çnjerëzuar, i trajtuar si mall apo i blerë dhe i shitur si “pronë”;
- i detyruar fizikisht apo ka ndalesa për lirinë e lëvizjes për ata apo ato.

### **Çfarë lloje të skllavërisë ekzistojnë sot?**

**Puna e detyruar** – i prekë së paku 10 milion njerëz në botë. Njerëzit bëhen punëtorë të detyruar duke e marrë apo duke u mashtruar që të marrin hua të vogla, si ajo e kostos së një ilaçi për fëmijën e tyre. Ata e pagujnë borxhin, ata janë të detyruar të punojnë shumë orë, shtatë ditë në javë, 365 ditë në vit. Ata marrin një “pagë” për ushqim dhe strehim, por kurr nuk do ta shlyejnë huanë, e cila mund të bartet në disa breza.

**Puna me detyrim-force** - prek njerëzit të cilët janë të rekrutuar ilegalisht nga qeveritë, partitë politike apo individët privatë, dhe janë të detyruar të punojnë – zakonisht nën kërcënim të dhunës apo me dënime.

**Format më të rënda të punës së fëmijëve**- u referohet fëmijëve të cilët punojnë në kushte të rrezikshme dhe të shfrytëzimit. Dhjetëra miliona fëmijë përreth botës punojnë me orar të plotë, të privuar nga arsimimi dhe argëtimi, që janë gjëra vendimtare për zhvillimin e tyre personal dhe social.

### **Shfrytëzimi komercial seksual i fëmijëve**

- fëmijët janë të shfrytëzuar për vlerën e tyre komerciale nëpërmjet prostitucionit, trafikimit dhe pornografisë. Ata shpesh kindapohen, të blerë dhe të detyruar që të hyjnë në tregun seksual.

**Trafikimi** – përfshin transportimin dhe / apo tregtinë e njerëzve, zakonisht femrave apo fëmijëve, për përfitime ekonomike, duke përdorur forcë apo mashtrime. Shpesh emigruet femra janë të mashtruara dhe detyruara të bjënë punë prostitucioni.

**Martetat e hershme dhe të detyruara** - prekin femrat dhe vajzat të cilat martohen pa zgjidhje dhe janë të detyruara t'i jetojnë jetët e tyre si shërbëtore, shpesh të përcjella me dhunë fizike.

**Skllavëria tradicionale apo trajtimi si 'plaçkë'** –përfshin blerjen dhe shitjen e njerëzve. Ata shumë shpesh rrëmbehen nga shtëpitë e tyre, trashëgohen apo dhurohen si dhurata.

## **BURIMI**

ANTI SKLLAVËRIA, 2002.

## **Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore**

*E drejta për punë*

**Neni 6 i KNDESK** ofron të drejtën e punës, e cila përfshin të drejtën e çdonjërit për mundësinë që ta realizojë jetesën e vet duke punuar lirshëm punë të zgjedhur dhe të

*pranuar. Hapat që duhet ndërmarrë... për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte duhet të përfshijnë udhëheqësi teknike dhe profesionale dhe programe të trajnimit.*

*Puna: E drejtë apo Obligim?*

Pse na duhet e drejta e njeriut për të bërë diçka që është detyrë, e ndërlidhur me tendosjen apo çështjen fizike apo psikike? Për këto ngatërime negative, është një konfuzion i shpeshtë sa i përket konceptit mbi të drejtën për punë. Puna, megjithatë, është e ndërlidhur ngushtë me dinjitetin njerëzor dhe të atyre që marrin pjesë në shoqëri, përderisa papunësia mund të shkaktojë frustrime të rënda dhe ndoshta edhe depresion. Puna po ashtu mund të jetë mjet për vetërealizim dhe kontribut të zhvillimit të personalitetit.

E drejta për punë siguron se askush nuk është i përjashtuar nga bota e punës vetvetiu - e drejta merret kryesisht me qasjen për të punuar, por po ashtu mbulon mbrojtjen e përjashtimit të padrejtë. Megjithatë, në fakt ajo nuk përfshin garancinë për të punuar, papunësia ekziston në të gjitha shpalljet, por qeveritë duhet të marrin hapa me të gjitha mjetet e mundshme për të arritur realizimin e plotë të të drejtës (Neni 2 KNDESK).

*E drejta për kushte të duhura dhe të favorshme të punës*

**Neni 7 KNDESK** - ... *Palët shetërore- njohin të drejtën e çdonjërit për ... kushte të duhura dhe të favorshme të punës, të cilat sigurojnë... paga përkatëse dhe shpërblime të barabarta për punën me vlerë të njëjtë të çdo lloji...; një jetesë të përshtatshme... kushte të sigurt dhe të shëndetshme të punës; promovimi i mundësisë së barabarë për çdokë...; pushimi, koha e lirë, dhe kufizimet e arsyeshme të orëve të punës...*

Neni, ndër të tjera, ofron shpërblim minimal, duke garantuar një jetë të rehatshme, si dhe kushte të favorshme të punës. Është shumë ngushtë e ndërlidhur me konventat e shumta të miratuara nga ONP të cilat po ashtu përdoren nga Komisioni mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore që t'i konkretizojë obligimet shtetërore që rrjedhin nga kjo dispozitë.

*E drejta për formimin dhe bashkimin në sindikata*

**Neni 8 KNDESK** *...palët shtetërore e njohin të drejtën e çdonjërit sipas zgjedhjes së tyre, që të formojnë sindikata dhe t'u bashkohen sindikatave... për promovimin dhe mbrojtjen e interesit ekonomik dhe social....; e drejta për greva...*

Bashkimi në një organizatë ka qenë gjithmonë një mënyrë për njerëzit që ta shtojnë sigurinë, si në vend të punës, po ashtu edhe në bashkësi apo komunitet.

**Neni 8 KNDESK** është i lidhur ngushtë me të drejtën e lirisë së shoqërorizimit. E drejta për mbledhje kolektive e bën lirinë e shoqërorizimit më efektive në botën e punës. Këto të drejta janë konsideruar shumë të rëndësishme, sepse ato shumë shpesh e mbajnë çelësin e realizimit të të drejtave të tjera themelore dhe të titullimeve në punë. Lufta kundër punës së fëmijëve edhe sot e kësaj dite nuk ka angazhimin e njëjtë publik, për shembull.

*Trajtimi i barabartë dhe të drejtat jodiskriminuese*

Kur flasim për të drejtat të lidhura me punën, masat mbi parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë nuk mund të lihen anash. Rregullat e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë mbizotërojnë të gjithë ligjin e të drejtave sociale. Kujdes të veçantë duhet të kemi për rregullat të cilat sigurojnë trajtim të barabartë të femrës në tregun e punës.

Moduli i të drejtave të njeriut për femrën.

Një moment historik i rëndësishëm për njohjen e të drejtave të femrave në përfshirjen e saj në mundësitë ekonomike, ka qenë miratimi i Konventës së KB mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundrejt femrës, një instrument ndërkombëtar i cili i shqyrton të drejtat e shtimit të femrat. Në mënyrë që të parandalojnë diskriminimin e femrës në kushte të martesës apo amësisë dhe t'i sigurojnë të drejtën e tyre për punë, palët shtetërore duhet ndalojnë përjashtimin nga puna për shkak të shtatzanësisë, pushimit të lindjes dhe diskriminimit mbi bazën e jetës bashkëshortore. Gjithashtu, ata duhet ta fusin pushimin e lindjes nën pagë apo të ketë përfitime të ngjashme shoqërore, pa e humbur vendin e punës.

**Shkallët e obligimit**

Efekti i fundit i instrumenteve ndërkombëtare është gjithmonë pjesë mbi masat e marra nga qeveritë që t'i fuqizojnë obligimet e tyre legale ndërkombëtare. Detyrimet e shteteve të ndërlidhura me të drejtat e lartpërmendura përfshijnë:

➤ **Obligimin për respekt:**

Obligimi më kryesor është se shtetet duhet të respektojnë lirinë nga skllavëria dhe puna e detyruar. Edhe një aspekt i rëndësishëm është respektimi i lirisë së shoqërimit, për t'iu bashkangjitur sindikatave. Duke pasur potencialin për të bërë presion mbi shtetin për t'i zbatuar të drejtat e tjera të rëndësishme të punëtorëve, këto të drejta ndodh që të shkenen shumë shpesh.

➤ **Obligimi për të mbrojtur:**

Palët shtetërore janë të detyruara që të krijojnë standarde minimale nën të cilat nuk do të lejohen të bien kushtet e punës të asnjë punëtori. E drejta për punë, për më tepër, kërkon mbrojtje nga përjashtimi dhe në çdo rast shtetet duhet të sigurojnë mbrojtje kundër diskriminimit gjatë kohës së punës.

➤ **Obligimi për promovim/shtytje:**

Duke marrë parasysh punën, ky obligim mund të kuptohet si një obligim që të ndihmojë qasjen në punë, duke ofruar udhërrëfim profesional dhe ndihmë trajnuese.

➤ **Obligimet për përmbushje**

Edhe pse e drejta për punë shumë herë është keqkuptuar në këtë pikëpamje, ajo nuk u kërkon shteteve të garantojnë punë për çdonjërin, por i thërret shtetet që t'i ushtrojnë politikatat për të arritur eknomi stabile, zhvillim social e kulturor dhe një punësim të plotë dhe produktiv.

### **3. PRESPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET KONTRAVERSE**

Brendapërbrenda kornizës juridike ndërkombëtare, aktivitetet e zbatimit duhet të marrin në konsideratë dallimet mësimore të njerëzve të cilët e përjetojnë një botë të përbashkët të

punës në mënyra të ndryshme. Përralla e mirënjohur e peshkatarit është një ilustrim për faktin se “puna” ka vlera të ndryshme në suaza të ndryshme kulturore dhe kjo do të thotë se masat e ndërrimit të llojit të punës duhet të jenë të drejtpeshuara mirë.

### **Përralla: Peshkatar**

*Një mëngjes një peshkatar po rrinte i shtrirë në një plazh të bukur, me rrjetat e tij të shpërndara nëpër rërë, ai po kënaqej me ngrohtësinë e diellit, duke shikuar valët e kaltra shkumbëzuese.*

*Ndërkohë, një turist erdhi duke ecur plazhit. Ai e vërejti peshkatarin duke qëndruar ulur në plazh dhe vendosi që t’ia qëllojë se përse ky peshkatar po relaksohej në vend që të punonte shumë, përë ta siguruar jetesën për vete dhe familjen e tij.*

*“Ju nuk do të kapni shumë peshk në atë mënyrë”, tha turisti, “ Ju duhet të punoni më shumë, më mirë sesa të shtrihen në plazh!”*

*Peshkatarin shikoi lart drejt tij, buzëqeshi dhe iu përgjigj,  
“Dhe cili do të jetë shpërblimi për mua?”*

*“Pra, mund të blesh rrjeta më të mëdha për të zënë më shumë peshk!” ishte përgjigja e turistit.*

*“Dhe cili do të jetë shpërblimi për mua?” pyeti peshkatarin, duke buzëqeshur ende.*

*Turisti iu përgjigj, “ju do të bëni të holla dhe do të keni mundësi që ta blini një anije, e me çka do të mund të zini edhe më shumë peshk!”*

*“Dhe cili do të jetë shpërblimi për mua?”, pyeti srisht peshkatarin.*

*Turisti filloi të ndihet paksa i irrituar nga pyetjet e peshkatarit. “Ju mund të blini një anije më të madhe, dhe t’i punësoni disa njerëz për të punuar për ju!” ai tha.*

*“Dhe cili do të jetë shpërblimi për mua?”*

*Turisti filloi të nevrikoset. “ A nuk kuptoni ju? Ju mund të bëni një flotë me anije peshkimi, të lundroni përreth botës, dhe mund t’i lini punëtorët tuaj të peshkojnë për ju!”*

*Edhe një herë peshkatari pyeti. “Dhe cili do të jetë shpërblimi për mua?”*

*Turisti ishte skuqur dhe i bërtistë peshkatarit. “ A nuk kuptoni ju se mund të bëheni i aq i pasur sa nuk do të keni nevojë për të punuar më për jetesën tuaj! Ju mund t’i kaloni ditët e mbetura duke u ulur, duke e shikuar perëndimin e diellit. Ju nuk do t’u mbetet merak në këtë botë!”*

*Peshkatari, ende duke buzëqeshur, e shikoi dhe i tha, “ Dhe çka mendon ti se po bëj në këtë moment?”*

#### **4. ZBATIMI DHE MONITORIMI**

Konventat e ratifikuara nga shtetet janë marrëdhënie në mes tyre. Tashmë efektiviteti i instrumenteve ndërkombëtare varet nga gatishmëria e shteteve që t’i fuqizojë ato nëpërmjet ligjeve nacionale pajtuar me hulumtimet e autoriteteve të monitorimit. Janë vetëm disa mundësi kufizimi të sanksioneve kundër shtetit në rast prishjeje të obligimeve të tij. Shpesh hyrja në fuqi varet nga *“mobilizimi i turpit”*. Në ekonominë e globalizmit mekanizmat e dobëta të fuqizimit kanë nxitur thirrjet të cilat i lidhin të drejtat e njeriut e në veçanti të drejtat e punëtorëve me tregtinë. Kjo mund ta hapë mundësinë për sanksione tregtare kundrejt shteteve që shkelin standardet ndërkombëtare. Para së gjithash, çështja është shumë kontraverse. Sanksionet tregtare mund t’i shtyjnë shtetet të marrin masa, si ndalimi i punës së fëmijëve, por me rregulla, problemet kërkojnë zgjidhje më komplekse.

Për fuqizimin e standardeve ndërkombëtare të ONP dhe KB caktohen procedura të ndryshme të mbikëqyrje dhe ankesave.

Shtetet palë të konventave të ONP duhet ti dorëzojnë raportet periodike që janë të analizuara dhe të komentuar nga ekspertët e komunitetit mbi aplikimin e konventave dhe rekomandimeve. Raportet nga ky komitet, si pasojë, dorëzohen në konferencën vjetore të ONP. Edhe pse kjo procedurë mund të shihet si një mjet i paaftë për zbatim, që nga viti 1967 në 130 shtete janë shënuar rreth 2000 ndryshime në legjislacionin nacional dhe social të punës!

Përveç këtij mekanizmi mbikëqyrës, ONP ofron procedurat e ankesës për zbatimin e standardeve të punës. E para, i lejon punëtorët apo organizatat punuese të padisin shtetin anëtar. Së dyti, lejon që shteti anëtar të bëjë ankesë kundër shtetit anëtar. Pas kësaj, mund të formohet komisioni i ankesave. Hulumtimet e këtyre komisioneve pranohen rregullisht nga shtetet e interesuara.

Është me rëndësi të përmendet se krahas kësaj ekziston edhe Komisioni mbi Lirinë e Shoqërimit për shqyrtimin e akuzave për shkeljen e të drejtave të sindikatës. Ankesat mund të bëhen nga çdo shtet, pa marrë parasysh a e ka ratifikuar konventen relevante apo jo. Zanafilla e komisionit e vitit 1950 ka pasur sukses që nga amandamentet e ligjeve, rikthimi i punëtorëve të përjashtuar në pozitën e mëparshme e deri te lirimi i sindikalistëve nga burgu.

Trupi i caktuar i KB i cili monitoron zbatimin e mirëfilltë të KNDESK është Komisioni mbi të Drejtën Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Ndryshe nga institucionet e tjera të të drejtave të njeriut, ai nuk ishte themeluar nga instrumentet e ndërlidhura, por ishte autorizuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social në vitin 1985 për monitorimin e Konventës dhe përbëhet nga 18 ekspertë të pavarur.

Palët shtetërore të Konventës duhet të dorëzojnë raportet çdo 5 vite, duke skicuar politikat juridike dhe masat e tjera që janë ndërmarrë për garantimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Pas analizimit të raporteve nëpërmjet Komisionit dhe diskutimeve të delegatëve të shteteve përkatëse, Komisioni lëshon komunikatat e tij në “vrojtimin përfundimtar”. Në shumë raste, Komisioni ka identifikuar shkeljen e

konventës dhe më pas ka nxitur shtetet që të pushojnë shkeljen e mëtutjeshme të këtyre të drejtave.

Ende nuk është bërë e mundur, megjithatë, për individët apo për grupet, që të dorëzojnë ankesa zyrtare mbi shkeljet e drejtave të tyre te Komisioni.

## **E DOBISHME TË DIHET**

### **1. PRAKTIKA TË MIRA**

#### **Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijës (PNEP)**

ONP ka zhvilluar Programin Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijës (PNEP). Duke punuar së bashku me qeveritë nacionale, si dhe me OJQ-të, ai zhvillon programe speciale duke marrë parasysh kompleksitetin e çështjes dhe nevojën e metodave të kujdesshme dhe të pajtueshme të rikujtimit të problemit. Do të duhet të gjejë alternativa për punën e fëmijëve, për shembull lansimi i programeve për t'i hequr fëmijët nga puna dhe t'u ofrojë atyre alternativa të arsimit, si dhe familjeve të tyre siguri dhe një burim tjetër të të hyrave. Gjatë dhjetë vjetësh të ekzistencës, PNEP ka mundur t'i zgjerojë veprimet operuese nga 6 shtete në 82 shtete.

#### **Mesatarja e fëmijëve aktiv në ekonomi në botërore nga mosha 5 deri 17 vjeçe në vitin 2000**

| Grupmosha               | Proporcioni i numrit të punësuar me gjithsej popullatën (%) |
|-------------------------|---|
| 5-9                     | 12,2  |
| 10-14                   | 23,0  |
| <b>Gjithsej (5-14)</b>  | <b>17,6</b>   |
| 15-17                   | 42,4  |
| <b>Gjithsej (5- 17)</b> | <b>23,0</b>   |

**BURIMI: ONP**

Në partnetitet me Federatën Afrikanë të Futbollit dhe organizatorët e Kupës së Popujve të Afrikës (COCAN), PNEP bëri një fushatë të madhe për të ngritur vetëdijën për çështjet e fëmijës në punë me rastin e kampionatit të Malit. Me një mesazh të drejtpërdrejtë: *“Karton i kuq për fuqinë punëtore të fëmijëve”*, të kuptueshëm për çdokë që është i njohu me sportin e futbollit, fushata përdori laramaninë e mediave të ndryshme – si video, muzikën e popullarizuar dhe shtypin, dy aviokompani ndërkombëtare dhe ndeshjet e futbollit – për t’i arritur miliona njerëz në Afrikë dhe përtej saj. Aktivitetet ishin marrë përsipër nga 21 popujt Afrikan dhe mediat nacionale në shumë vende e publikuan gjerësisht këtë fushatë. Është vlerësuar se 12 milionë njerëz e kanë marrë porosinë në Keni dhe 5 milionë në Zambë. Në disa vende afrikane, si Egjipti dhe Gana, entuziazmi për këtë kampanjë ishte aq i madh sa vazhdoi të jetë në agjendë në ndeshjet nacionale apo lokale të futbollit dhe në ngjarjet e tjera publike.

#### **A E DINI SE...**

... rreth 250 milion fëmijë ndërmjet të moshës 5 dhe 14 vjeçare punojnë me orar të plotë apo përgjysmuar. Kjo do të thotë se në çdo 100 fëmijë të botës, 16 punojnë për të mbijetuar.

... afërsisht gjysma e tyre, rreth 120 milion, punojnë me orar të plotë, çdo ditë, gjatë gjithë vitit.

... 70% e tyre punojnë në agronomi

... 70% e tyre punojnë në një ambient të rrezikshëm.

... nga 250 milion fëmijë që kanë lidhje me këto gjëra, 50 deri 60 milion janë nga 5 deri 11 vjeç dhe punojnë në kushte të rrezikshme, duke marrë parasysh moshën dhe njomësinë.

... fuqia punëtore e fëmijëve është po ashtu e zakonshme edhe në shtetet e zhvilluara.

Për shembull në Shtetet e Bashkuara, më shumë se 230 000 fëmijë punojnë në agronomi dhe 13 000 në dyqane ndërresash.

#### **BURIMI:**

KOMBET E BASHKUARA

➤ **Kodet e veprimeve të korporatave ndërlidhur me punën dhe të drejtat e njeriut**

Kompanitë multinacionale nuk mund t'i shmangen më përgjegjësisë për aktivitetet e tyre. Konsumatorët dhe OJQ ushtrojnë presion të konsiderueshëm mbi to që t'i përmirësojnë kushtet e punës në kompanitë e tyre. Gjithnjë e më shumë ky presion po rezulton me miratimin e kodeve të sjelljeve të korporatave, duke përfshirë këtu të drejtat e njeriut, standardet e punës si dhe çështjet e ambientit. Për më shumë shembuj ju lutemi vizitoni <http://www.umn.edu/humanarts/links/sice.html>

Shembulli më i mirë është *Levi Strauss & Co. Termet e Biznesit për Angazhim dhe Direktiva për Zgjedhje në Vend*, të cilat u drejtohen kontraktorëve dhe furnizuesve të kompanisë. Ata mbulojnë ndër të tjera, sigurinë profesionale dhe shëndetin, lirinë e shoqërimit, pagat dhe shtesat (benefitet), kohën e punës, punën e fëmijëve, punën e detyruar dhe praktikat jodiskriminuese të pranimit

Këto çështje, në të vërtetë, kanë një efekt pozitiv mbi kushtet sociale, por shpesh nuk kanë për qëllim një nivel të lartë të standardeve, për shembull ato të parashtruara nga instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por preferojnë më shumë standardet nacionale. Për më shumë, atyre u mungon një sistem i efektshëm monitorimi. Mund të debatohet, si pasojë, se shumë shpesh nuk japin më shumë sesa premtimet boshe prë t'i jetësuar standardet. Megjithatë, ato janë një hap në drejtimin e duhur, për ta rritur përgjegjshmërinë.

➤ **Shenjat (etiketa) e prodhimeve**

Shenja (etiketa) e prodhimeve të prodhuara në përputhje me praktikat e mira sociale është nxitur vazhdimisht si një kontribut për veprime më të mira sociale dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Ajo i lejon konsumatorëve që t'i influencojnë praktikat e prodhimit duke përdorur fuqinë e tyre blerëse në mbështetje të veprimeve të mira. Sot ekzistojnë praktika të emërimit në 17 vende, shumica në Evropë dhe SHBA, dhe gama e produkteve tash përfshin kafënë, çokollatën e lëngshme, çokollatat, lëngun e portokallit, çajin, mjaltin, sheqerin dhe bananet.

**Rugmark**, për shembull është një OJQ e cila punon për ta zhdukur punën e fëmijëve. Ofron shanse për arsimim për fëmijët në Indi, Nepal dhe Pakistan. Shenja (etiketa) e RUGMARK-ut siguron se asnjë fëmijësh nuk është punësuar në fabrikë të qilimave apo tepihëve.

**Fairtrade** – Fondacioni Fairtrade ekziston që të sigurojë marrëveshje më të mirë tregtare për prodhuesit e vendeve të treta. Ky fondacion dhuron etiketën e konsumatorit, liçencën FAIRTRADE, për produktet të cilat i arrijnë standardet e njohura ndërkombëtare të tregtisë. Etiketa gjendet në shitjen e shumë rrjeteve evropiane të supermarketeve.

### ➤ **Marrëveshja Globale**

*>>Na lejoni të zgjedhim të bashkojmë fuqitë e tregjeve tona me autoritetin e parimeve universale<<*

**KOFI ANNAN, SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KB**

“Marrëveshja Globale” (MG) është bazuar nga ideja e lansuar nga sekretari i përgjithshëm i KB Kofi Annan, duke iu adresuar Forumit Ekonomik Botëror më 31 janar 1999, duke thirrur komunitetet e biznesit që të pajtohen me vlerat e përkrahura dhe nënshkruara universalisht. Prirjes së shfaqur për përgjegjësinë e korporatave i mungonte një kornizë ndërkombëtare që t’i ndihmojë kompanitë për zhvillimin e tyre dhe promovimin e menaxhimit të bazuar në vlera. MG e plotësoi zbrastësirën dhe u pranua me të madhe nga komuniteti i biznesit.

Ajo i shtron 9 vlera, përfshirë këtu çështje të të drejtave të njeriut, punës dhe ambientit. Sa i përket punës ajo përfshin zotimet në pajtim me shumicën e standardeve themelore të punës të ONP.

- Liria e shoqërimit dhe njohjen efektive të së drejtës për mbledhje kolektive;
- Eliminimin e të gjitha formave e punës së detyruar apo shtrënguar;
- Ndalimin e efektshëm të punës së fëmijëve;
- Eliminimin e diskriminimit në bazë të punësimit dhe profesionit.

ONP ndihmon për formulimin e masave konkrete që t'i promovojë këto standarde me efektivitet.

Faqja e internetit <http://www.unglobalcompact.org> ofron qasje të lehtë në informatat mbi parimet e kësaj iniciative, duke përfshirë këtu edhe listën e kompanive pjesëmarrëse. Që nga lansimi, me qindra kompani dhe organizata janë lidhur me Marrëveshjen Globale.

Marrëveshja Globale është në rregullim vullnetar i parimeve. Meqenëse është njohur gjerësisht si një hap pozitiv për t'i inkurajuar korporatat që të veprojnë me përgjegjësi, disa pyesin se a mos vallë zbatimi i saj mund të jetë efektiv. Kritikët debatojnë se sfidat për efektivitetin e iniciativës janë mungesa e hyrjes në fuqi të standardeve, monitorimit të pavarur dhe mekanizmit të fuqizimit, dhe qartësisë për vetë përmbajtjen e standardeve.

## **2. TRENDET**

- **Zonat e Procesit të Eksportit (ZPE)**

Për t'i tërhequr investitorët e huaj shumë vende kanë themeluar të ashtuquajturat zona të lira tregtare, të cilat ofrojnë përjashtueshmëri jo vetëm për lirimet fiskale por po ashtu për obligimet për përputhje me ligjet të cilat i mbrojnë të drejtat e punëtorëve. Kompanitë multinacionale përfitojnë nga kostoja e lirë e fuqisë punëtore, por gjithashtu edhe punëtorët të cilët ikin në zonat, sepse rrogat prapëseprapë janë më të mëdha në krahasim me punët jashtë zonave. Nga ana tjetër, kushtet tjera të punës mund të jenë më të ulëta, si për shembull, siguria dhe çështjet shëndetësore. Pakujdesia për rregullat e parandalimit të zjarrit, dështimi i instalimit të mjeteve të ndihmës së parë dhe makineria e pasigurt janë disa probleme që mund të ndodhin në ZPE. Kushtet janë përmirësuar dukshëm me rritjen e publicitetit, por problemi mbetet, ZPE mund të gjendet në se paku 70 shtete. 845 ZPE e botë punësojnë 27 000 milionë punëtorë.

**BURIMI:** UNDPE 2000.

- **Dobësimi i sindikatave**

Në disa vende të zhvilluar, anëtarësimi në sindikata është shumë i ulët. Për shembull në SHBA vetëm 15 % e punëtorëve janë anëtarë të sindikatave. Fuqia e sindikatave është

shumë më e dobët se në të kaluarën. Në shumë shtetë në zhvillim, liria e shoqërimit për sindikatat mezi ekziston; pengesat e llojeve të ndryshme janë vendosur në rrugë të punëtorëve të organizuar, në disa vende, dhuna, tortura, vrasjet arbitrare dhe arrestimet arbitrare janë përdorur rregullisht për t'i parandaluar punëtorët për t'u bashkuar dhe t'i rivendosin të drejtat e tyre

- **Rritja e mobilitetit ndërkombëtar: migrimi i punëtorëve**

Varfëria dhe dhuna janë sot arsye tragjike që shtyjne miliona njerëz që t'i lënë vendet e tyre për të kërkuar një të ardhme më të mirë. Kjo dukuri është duke u rritur falë pabarazisë në zhvillimin ekonomik. Shumë shpesh punëtorët që migrojnë janë subjekt i të gjitha llojeve të diskriminimit dhe shfrytëzimit.

Gjithsej janë 150 milionë migrantë, të cilët përbëjnë 2% e popullatës botërore. 50 milion jetojnë vetëm në Afrikë. Sipas ONP më shumë se 100 milion prej migrantëve janë punëtorë, duke përfshirë këtu një pjesë të madhe nga të cilët janë femra (47,5%). Përveç kësaj llogarie është edhe numri në rritje i migrimeve klandestine, pa dokumentacion (30 milion njerëz). Këta numra lehtë mund të rriten përveç nëse pabarazitë në botën tonë të globalizuar do të ndërpriten në mënyrën e duhur.

Konventat e tashme të ONP mbi Migrimin e Punëtorëve (Konventat 97 dhe 143) janë ratifikuar vetëm nga disa shtete, për arsye se shtetet kishin frikë nga një kushtëzim i metutjeshëm i politikave të imigrimit. Një zhvillim pozitiv po hyn në fuqi “Konventa e KB mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre” dhjetor të vitit 2002, (falë ratifikimit të Timorit Lindor pragu kritik i 20 nënshkrimeve ishte kaluar), duke hapur perspektiva më të mira për migrantët në të gjithë botën.

>> *Rinia përbën më shumë se 40% të papunësisë botërore. Sot llogaritet që në botë të ketë diku rreth 66 milionë të rinj të papunë— një rritje e së paku 10 milionëve që nga viti 1965. Puna e përkohshme është po ashtu një problem në rritje. Shumica e punëve të reja janë të paguara ulët dhe të pasigurta. Gjithnjë e më shumë, të rinjtë po drejtohen në sektorin jozyrtar për mjete jetese, me pak apo fare pa mbrojtje pune, beneficione, apo prespektivë për ardhmëri.<<*

**KOFI ANNAN, SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KB, 2001.**

- **Papunësia e të rinjve**

Njëri nga problemet më tmerruese me të cilin përballen njëlloj vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim është numri në rritje i papunësisë së të rinjve.

Rajonet më të prekura janë Evropa Jugore (Greqia, Spanja dhe Italia), Evropa Lindore (Bulgaria në veçanti, Ish-republika Jugosllave e Maqedonisë, dhe Polonia) dhe Karaibet (përfshirë Xhamajkën, Trinidadin dhe Tobagon). Megjithatë papunësia te të rinjtë nuk është e lartë në të gjitha vendet. Në Austri, Japoni, Meksiko, Singapor, Kore Jugore, Republikën e Bashkuar e Tanzanisë, më pak së një në 12 punëtorë është i papunësuar dhe dallimi në mes të normës të të rinjve dhe të rriturve është shumë i ulët. (Të dhënat e vendeve të vitit 1997 ose më herët, ONP).

...Sot në botë jetojnë më shumë se 510 milion të reja dhe më shumë se 540 të rinj, sipas llogaritjeve të Kombeve të Bashkuara.

... kjo do të thotë se një person në mesin e pesëve është në mes të moshës 15 dhe 24 vjeçe, apo rinia përbën 18 për qind të popullatës botërore.

... në mesatare, dhe gati gjithkund, për çdo të papunë të rritur, dy të rinj e gjejnë vetveten të papunë.

... rreth 70 milionë të rinj janë të papunë në të gjithë botën, sipas llogaritjeve të ONP.

... në vendet e ndryshme si Kolumbia, Egjipit, Italia dhe Xhamajka, më shumë se një e treta e të rinjve janë të renditur si të “papunë” – duke e deklaruar vetveten të papunë, duke kërkuar punë dhe/ose duke qenë të gatshëm për punë.

Çdo gjë e ngjashme me papunësinë afatgjatë shkakton shqetësim social dhe pasojat e të qenit i papunë në rini mund të jenë shumë serioze. Papunësia në rini shumë herë mund të shoqërohet me probleme të rënda sociale si dhuna, krimi, vetëvrasja dhe përdorimi i narkotikëve dhe alkoolit, duke përjetuar kështu një rreth të mbrapshtë. Politikat efektive të rinisë dhe programet duhet që të shqyrtohen hollësisht, për të marrë parasysh aftësitë tona specifike, nevojat dhe dallimet.

## **AKTIVITETE TË ZGJEDHURA**

### **VEPRIMTARIA I: FEMRA- FËMIJËT-PUNA**

#### **PJESA I: HYRJA**

Ky aktivitet përfshin aktin dramatik për çështjet e të drejtave të femrës për lindje dhe për vendin e punës. E drejta e lindjes përfshin të drejtën e zgjedhjes, për të pasur apo për të mos pasur fëmijë.

**Lloji i aktiviteti:** pjesë teatrore / aktrim

#### **PJESA II: PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM PËR PJESËN TEATRORE**

##### **Qëllimet dhe synimet**

Ky rol dramatik ka për qëllim zhvillimin e dijes për të drejtën e femrës për lindje, dhe provon t'ua krijojë pjesëmarrësve një ndjenjë se si është të jesh i diskriminuar dhe që në anën tjetër të promovosh barazi, drejtësi dhe përgjegjësi.

**Grupi i synuar:** të rinjtë, të rriturit

**Madhësia e grupimit / organizimi shoqëror:** 15 - 20

**Koha:** rreth 1 ½ orë

**Aftësitë e përfshira:** mendimi kritik, ndërtimi i opinionit, shkathtësitë gjuhësore dhe ndieshmërisë.

#### **PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR PJESËN TEATRORE**

##### **Hyrje në temë:**

- Lexo historikun e skenarit për shfaqjen teatrore

“Maria ishte e papunë për afërsisht një vit dhe ajo po përpiqet për një punë të re. Dhjetë ditë më parë ajo kishte një intervistë për punën e ëndrrave të saj. Çdo gjë shkoi si duhet dhe asaj ju ofrua pozita. Kompania i kërkoi asaj të takohet me z. W., zyrtarin e personelit, për ta nënshkruar kontratën. Ajo i kishte diskutuar detyrat e saj dhe çështjet e tjera të ndërlidhura me punë në intervistën e saj, por sapo Maria deshi ta nënshkruajë kontratën,

z. W. iu drejtua se një kusht i punës ishte që ajo ta nënshkruajë një deklaratë që nuk do të ketë fëmijë për së paku dy vjet.”

### **Shfaqja e pjesës teatrale:**

- Ndajini grupet në grupe më të vogla ( 4-6 persona )
- Lexojeni skenarin dhe lejojeni çdonjërin nga grupet e vogla që për njëzet minuta të nxjerrin përfundimin për tregimin dhe të zhvillojnë një pjesë teatrale. Pjesa teatrale duhet të fillojë me takimin e Marias me Z.W. dhe nuk duhet të zgjasë më shumë se pesë minuta.
- Ftoje secilin grup të vogël që të prezantojnë pjesën teatrale – ju mund t’i përdorni edhe metodat në vazhdim
  - Ndërrimi i roleve: pa paralajmërim, ndale shfaqjen, kërkoj nga aktorët që t’i këmbëjnë rolet dhe të vazhdojnë formën e veprimit nga ajo pikë. Pyeti thellësisht.
  - Përsërit: pas shfaqjes teatrale, ndërro situatën (p.sh. është e pamundshme të mbeteni shtatzënë, ju tashmë jeni shtatzënë...) dhe kërko nga aktorët ta përsërisin skenën e njëjtë pa ndryshime.
  - Bëj komentet për pyetjet e thella.

### **Vlerësim:**

- Fillo vlerësimin nga çdo grup i vogël (si e kanë zhvilluar pjesën teatrale; a ka qenë vështirë?), pastaj bisedo për ndërlikimet dhe çka duhet të bëhet në rastet e diskriminimeve të këtij lloji.
  - *A ishte ndokush i befasuar nga situata?*
  - *Përçqfarë përfundimi kishin vendosur grupet (përfundime realiste? Pika të forta – pika të dobëta? A është më mirë të jesh kategorik, agresiv apo i nënshtruar?)*
  - *Çfarë të drejtash kanë femrat në vendin tuaj (në veçanti kur janë shtatzëna?)*
  - *Pse kompania kishte reaguar ashtu – ishte e drejtë?*
  - *A ishte shkelur ndonjë e drejtë e njeriut? Nëse po, cilat?*

- *Nëse Maria do të ishte mashkull, a do t'i ndodhte e njëjta gjë?*
- *Në çfarë mënyrash e shohin meshkujt e këtë çështje; ndryshe nga femrat?*
- *Çka mund të bëhet që të promovojmë dhe të mbrojmë të drejtat e femrës për lindje?*

### **Këshilla metodologjike:**

- Shpjego për grupin se çka janë të drejtat për lindje.
- Mund të provoni të formoni grupe me gjini të njëjtë për arsye që kjo mund të çojë në përfundime më provokative.
- Ngulitini në mendje se diskutimi për abortin mund të ngritet dhe kërkon nga pjesëmarrësit që të lihen anash opinionet stereotipe dhe të paramenudara.

### **Sygerime për ndryshim**

- Fillo me dy vullnetarë që të luani shfaqjen teatrale, me pjesën tjetër të grupit si shikues.
  - *Ndale shfaqjen kohë pas kohe dhe kërko komente*
  - *Leji shikuesit që t'i ndërrojnë rolet me aktorët*
  - *Futni karaktere të tjera në situatë ( burrin, përfaqësuesin e sindikatave).*
- Lejo grupin që të bëjë pak hulumtim për të drejtën e lindjes në vendin tuaj (intervista, pjesëmarrje në shfaqje për të drejtat e njeriut në vende publike – ftojini shikuesit që marrin pjesë).

### **PJESA IV: VAZHDIMI**

**Të drejtat e ndërlidhura / fusha të tjera të hulumtimit:** të drejtat sociale, barazia gjinore, diskriminimi, ksenofobia

**Burimi:** Adaptuar nga: *Shtrirja: Doracaku për të Drejtën e Arsimimit për Njerëzit e Rinj. Viti 2002. Cedex Strasburg: Publikim i Këshillit të Evropës.*

## **AKTIVITETI II:**

### **DREJTËSIA/PAANËSIA EKONOMIKE**

#### **PJESA I: HYRJE**

Shpërndarja e pasurisë dhe fuqia brenda shoqërisë shpesh i dëmton gjasët e njerëzve për t'i arritur të drejtat e plota njerëzore dhe të jetuarit me dinjitet. Në këtë studim rasti pjesëmarrësit do ta shqyrtojnë konceptin e “drejtësisë/paanësisë” dhe pasqyrimin e tyre në situata. Ata vënë lidhje në mes të rrobave të tyre dhe njerëzve që i bëjnë ato.

**Lloji i aktivitetit:** rasti për studim

#### **PJESA II: PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM MBI RASTIN PËR STUDIM**

##### **Qëllimet dhe synimet**

Ky lloj aktiviteti u ndihmon pjesëmarrësve që të vënë lidhje ndërmjet rrobave të tyre dhe njerëzve që i bëjnë ato. Në parim ata parashtojnë pyetje për përgjegjësitë tona.

**Grupi i synuar:** të rinjtë, të rriturit

**Madhësia e Grupimit / organizimi shoqëror:** rreth 25

**Koha:** rreth 1 ½ ore

**Materiali:** hamerë apo tabelë e zezë, markerë apo shkumës; pyetjet për diskutim

**Shpërndaj:** trikot (fanela)

**Aftësitë e përfshira:** analizimi, reflektimi, shkathtësitë gjuhësore dhe kritike; aftësia për të shkruajtur.

#### **PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR PJESËN TEATRORE**

**Hyrje në rast:**

**Triko (fanela) (shpërndahet):**

Një triko që shitet 20\$ ne Shtetet e Bashkuara është prodhuar nga një korporatë ndërkombëtare në njëren nga fabrikat e saj në El Salvador. Fabrika është një shembull tipik i një fabrike të rrobaqepësit të huaj që mbledh të mirat për eksport. Punëtorët salvadorian që prodhojnë trikon paguhen 0.56 \$ në orë. Si mesatare, një punëtor mund të qepë 4.7 triko për orë.

Duke përdorur informatat e poshtëshënuara, llogaritni me sa vijon:

- Sa të holla i merr punëtori për një triko?

Në vitin 1994, qeveria salvadoriane llogariti se për të mbajtur familjen në shkallë të ekzistencës, do të duheshin katër herë më shumë sesa pagat e dhëna për punëtorët e rrobaqepësisë.

- Nëse rroga e punëtorit është e ndarë në katër, sa do të duhej të merrnin për orë?
- Sa do të fitonin për një triko?
- Nëse kompania e aprovon këtë, sa do të rriten kostot e konsumatorit dhe rrjedhimisht, sa do të kushtonte një triko?

Tash imagjinoni se rroga e punëtorit është rritur për dhjetë herë?

- Sa do të ishte norma e orës?
- Sa do të fitonin për një triko?
- Nëse kompania e aprovon këtë, sa do të rriten kostot e konsumatorit, dhe rrjedhimisht sa do të kushtonte një triko?

### **Instruktionet për studimin e rastit:**

#### **Ngrohja:**

Kërko nga të gjithë anëtarët e grupit që të shikojnë etiketat të cilat mund t'i gjejnë në rrobat e tyre. Pastaj bëni një listë (në hamerë apo në tabelë të zezë) dhe shëno të gjitha informatat për etiketat dhe vendet se ku janë prodhuar. Pasi të përfundojë kjo listë, kërko nga pjesëmarrësit që t'i analizojnë rezultatet. Në gati çdo rast do të rezultojnë se shumica e veshjeve janë punuar në vendet e varfëra. Diskuto me të gjithë grupin pyetjet në vijim:

#### **KUSH**

- mendoni ju se i ka bërë rrobat tuaja, syzet e diellit, këpucët, pullat, zinxhirin, dekorimet e tjera...?
- do të ishte punuesi - mashkull, femër, fëmijë???

#### **ME ÇFARË**

- imagjinoni se paguhen këta punëtorë?
- Çfarë kushte të punës ata përballen?

Radhitni rezultatet në hamer/tabelë të zezë.

### **Evalumi i rastit**

- Shpjegojani grupit se ky rast duhet të evaluojë bazueshmërinë e pretendimit të bërë shpesh nga tregtuesit e rrobave kur u drejtohen për kërkesën e rrogave më të mira për punëtorët të cilët i bëjnë rrobat tona. Ata shpesh pohojnë se rrogat duhet të mbahen të ulëta, për arsye se konsumatorët duhet të kenë produkte të lira
- Dorëzoja rastin çdonjërit - anëtarët e grupit duhet t'u përgjigjen pyetjeve në çifte.
- Dorëzoi grupit pyetjet e mëposhtme
  - *A do të ishit në gjendje të paguanit më shumë për triko? Nëse po – atëherë sa?*
  - *A është shkelur ndonjë e drejtë e njeriut nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut? Cito nenet specifike.*
  - *Pse prodhuesit i shesin prodhimet në botën perëndimore, ndërsa i prodhojnë në El Salvador?*
  - *Kush do të duhej të ishte përgjegjës për t'i bërë rrogat e punëtorëve të El Salvadorit të mjaftueshme për mbështetje të tyre dhe të familjeve?*
  - *Diskutoji këto pyetje në grup.*

### **Vlerësim**

- Parashtro një pyetje përmbledhëse
  - Çfarë vërejtjesh keni dëgjuar këtu sot e që do ta kujtosh si të arsyeshme
  - Proveni të mendoni një fjalë apo frazë e cila i përmbledh ndjenjat tuaja?
- Kërko nga pjesëmarrësit që të pyesin me radhë

### **Këshilla metodologjike:**

Rastet e studimit shpesh janë të disenjura për të pasur debate efektive. Me këtë rast është e nevojshme të krijohet një ambient i besimit dhe respektit, ku pjesëmarrësit do të merrnin pjesë në diskutim. Prandaj, i gjithë grupi duhet të mendojë për disa parime të

diskutimit, të cilat ata mendojnë se çdonjëri do t'i ndjekë. Shkruaji të gjitha këto sygjerime dhe vendosi në një vend, ku mund t'i shohë çdokush.

### **Sygjerime për ndryshim**

Le të bëjë i gjithë grupi një ushtrim. Dorëzoji shenjat (etiketat) dhe përmend gjininë, moshën dhe sa paguhet ky person për punën e tij (p.sh. 10 triko për 5 minuta punë; 2 triko për 10 minuta...). Kur të kryhet detyra, paguaj çdo person sipas moshës dhe gjinisë, duke u bazuar në etiketat e tyre. Numëroji “të hollat” (trikot) dhe nxirri jashtë, në mënyrë që çdonjëri të jetë i vetëdijshëm se sa paguhet ai tjetri për punën e njëjtë të bërë. Bisedo për ndjenjat e tyre. Dorëzoni trikot.

### **PJESA IV: VAZHDIMI**

#### **Të drejtat e ndërlidhuar/fushata e mëtejme hulumtimit**

Të drejtat sociale, politike dhe ekonomike.

#### **BURIMI:**

E ADAPTUAR NGA : DAVID A. SHIMAN. 1999, DREJTËSIA EKONOMIKE DHE SOCIALE. PRESPEKTIVA E TË DREJTAVE TË NJERIUT. MINESOTA: QENDRA E RESURESEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT E UNIVERSITETIT TË MINESOTËS.

#### **BIBLIOGRAFIA**

**Antisklavëria dhe ICFTU. 2001.** Puna e detyruar në shekullin 21. Londër: Anti-Slavery International.

Anti-Slavery International: <http://www.antislavery.org>

**Deutsche Gesellschaft fur die Vereinten Nationen. 2001.** Menchrechte und menschliche Entwicklung. Anregungen zur Arbeit mit dem UNDP \_ Bericht uber die menschliche Entwicklung 2000 in Schulen. Bonn: DGVN.

**Krzystof Drzewicki. 2001.** E drejta për punë dhe të drejtat në punë. Edituar nga Ajsborn Eide, Catarina Krause dhe Allan Zrosas. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Tekst shkollor. Dordrecht: Botuesit Martinus Nijhoff.

**Berna Klein Goldewijk, Adaid Contreras Baspineiro and Paulo Cesar Carbonari. 2002.** *Dinjiteti dhe të drejtat e njeriut, Zbatimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.* Antwerp: Intersentia.

**Qendra Burimore e të Drejtave të Njeriut.** *Rrethi i të drejtave. Aktivizmi i të drejtave ekonomike, kulturore, dhe sociale: Burimi i trajnimeve.* I gatshëm në: <http://www.hrusa.org/hrmaterials/IHRIP/circle/toc.htm>

**Zyra Ndërkombëtare e Punës. 1999.** *Puna e përshtatshme.* Konferenca Ndërkombëtare e Punës, sesioni i 87-të 1999. Gjenevë: Publikime të ONP.

**Zyra Ndërkombëtare e Punës. 2000.** *Zëri juaj në punë. Raporti global deri në vazhdimin e Deklaratën e ONP të Parimeve Themelore dhe të Drejtat në Punë.* Gjenevë: Publikime të ONP.

**Zyra Ndërkombëtare e Punës. 2001.** *Ndalimi i punës së detyruar, Raporti Global deri në vazhdimin e Deklaratën e ONP të Parimeve Themelore dhe të Drejtat në Punë.* Gjenevë: Publikime të ONP.

**Virginia A. Leary. 1995.** *Qasje e shkeljeve të të drejtave në punë (të drejtat e punëtorëve).* Edituar nga Theo Van Boven, Cees Flinterman dhe Ingrid Westendorp. *Udhëzuesi i Mاستrihtit mbi shkeljet e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.* SIM Special nr. 20, Urtecht: Instituti Holandez për të Drejtat e Njeriut.

**Virgina A. Leary.1998.** *Globalizmi dhe të Drejtat e Njeriut.* Edituar nga Januzs Symonides. *Të drejtat e njeriut: Dimensione dhe sifida të reja.* Aldershot: Dartmouth Publishing Company Limited.

**Leah Levin. [1981] 1996.** *Të drejtat e njeriut. Pyetje dhe përgjigje.* Paris: Botime të UNESCO.

**Allan McChesney. 2000.** *Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.* New York: Shoqata Amerikane për Përparimin e Shkencës.

**David A, Shiman. 1999.** *Drejtësia ekonomike dhe sociale. Prespektivë e të drejtave të njeriut.* Minneapolis: Qendra Burimore e të Drejtave të Njeriut.

**Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim. 2000.** *Raporti i zhvillimit njerëzor. Të drejtat e njeriut dhe zhvillimi i njeriut.* New York: Shtypi i Universitetit të Oksfordit.

**Kombet e Bashkuara. 1996.** Komisoni mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, Gazeta e faketeve nr. 16. Gjenevë: Kombet e Bashkuara.

**Kombet e Bashkuara. 1998.** Kombet e Bashkuara në përditshmërinë tonë, një përshkrim i shkurtër i KB dhe agjencive të tij speciale. Gjenevë: Kombet e Bashkuara.

**Kombet e Bashkuara. 1996.** Ne njerëzit: roli i Kombeve të Bashkuara në shekullin 21, Artikuj të shkurtër për studentë. New York: Publikme të KB.

**ONP.** Çka janë standardet ndërkombëtare të punës? Në dispozicion në:

<http://www.ilo.org/public/english/standards/norm/whatare/index.htm>

**INOFRMATA PLOTËSUESE**

**Anti – Slavery International:**

<http://www.antislavery.org>

**Bread and Roses:**

<http://www.bread-and-roses.com/>

**Buletini Kinez i Punës**

<http://www.china-labour.org.hk>

**Punëtorët Fëmijë në Azi**

<http://www.cwa.tnet.co.th/>

**Marshi Global Kundër Punës së Fëmijëve:**

<http://www.globalmarch.org/>

**Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave:**

<http://www.icftu.org>

**Organizata Ndërkombëtare e Punës.**

<http://www.ilo.org>

**Organizata Ndërkombëtare për Migrim**

<http://www.iom.org>

**Hyrja antisklavëri:**

<http://www.iabolish.com>

**Të Brengosurit për Fëmijët që Punojnë (BFP):**

<http://www.workingchild.org/htm/cwc.htm>

**Fondacioni për tregti të drejtë:**

<http://www.fairtrade.org.uk/>

**Qendra Adresuese mbi Përgjegjësinë e Shoqerore të Korporatave:**

**<http://www.csreurope.org/home/default.asp>**

**UNICEF:**

**<http://www.unicef.org/crc/>**